

STATUT

I

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR (SH.P.K.) "BIOMETRIC" ALBANIA

Ortakët e shoqërisë "BIOMETRIC" që me pas të do të quhet për lehtësi Shoqëria, veç kontratës për themelimin e kësaj shoqërie hartuan dhe nënshkruan edhe statutin e saj sot në datën

Kreu I

Dispozita të përgjithshme

Neni 1

Shoqëria emërohet "BIOMETRIC" Albania (SH.P.K.)

Shoqëria është person juridik. Ajo e fiton këtë të drejtë nga data e regjistrimit në gjykatën e rrethit Tiranë.

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar, me dispozitat e parashikuara në dokumentin e themelimit të saj (kontraten) dhe në këtë statut.

Neni 2

Shoqëria me objektin e veprimtarisë së saj ka për qëllim eksport importin e mallrave të ndryshme industriale, elektromjeksore e të medikamenteve farmaceutike, si dhe shitjen me shumicë dhe pakicë të këtyre mallrave. Ajo do të hapë edhe laboratore për analizë mikrobiologjike dhe do të administrojë veprimtarinë e tyre.

Neni 3

Shoqëria e ka selinë e saj në Tiranë në rrugën "Myslym Shyri" pallati 23 shkalla 2 apartamenti 10.

Shoqëria mund të çele filiale degë e perfaqësi në qytete të tjera të vendit. Këto njësi strukturore të shoqërisë do të krijohen në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 5

Objekti

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë së saj:

- Eksport Importin e mallrave të ndryshme industriale, elektromjekso-
re e të medikamenteve farmaceutike, si dhe shitjen me shumicë e pa-
kice të këtyre mallrave, ashtu edhe prodhimin e tyre në Shqipëri.
- Hapjen e laboratoreve për analizë mikrobiologjike dhe administrim-
in e veprimtarisë së tyre.

Neni 6

Kohe zgjatja e shoqërisë

Shoqëria do të vazhdojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe

Neni 7

Kapitali Themelor

Kapitali themelor i shoqërisë caktohet ^{dy milion lek} 2.000.000 (dy mijë ditonxxx) leke dhe përbehet nga shuma të derdhura në para. Ortaket marrin pjesë në kapitalin themelor si më poshtë:

1. Fotis Sarantopoulos, ortak i huaj me 1.000.000 lek = me 50%
2. Artur Kadare, ortak vendas me 1.000.000 lek = me 50%

Ky kapital themelor ndahet në pjesë të barabarta, vlera nominale e të cilave nuk mund të jete më e vogël se 1000 (njemije) leke.

Neni 8

Kapitali i shoqërisë, që përfaqësohet nga kapitali themelor, nga mjetet e xhiros etj. të nevojshme për veprimtarinë e saj, është i destinuar vetëm për qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së shoqërisë. Te hollat dhe likuiditetet financiare do të depozitohen pranë bankës ku shoqëria do të hapë edhe llogaritë perkatese.

Neni 9

Fitimi i realizuar nga shoqëria gjatë një viti i i nënshtrohet taktimit, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Pjesa që mbetet do të ndahet ndërmjet ortakëve në proporcion me pjesën që i takon çdo ortakut në kapitalin themelor.

Pjesa e fitimit, ose edhe çdo shperblim tjetër që i takon ortakut të huaj mund të transferohet lirshëm jashtë shqiperisë në valutën e zgjedhur prej tij, si dhe në llogarinë e bankës së huaj të caktuar prej vete atij.

Neni 10

Organet e Shoqërisë

Organet e shoqërisë janë: Asambleja e Ortakëve dhe Administratori.

Menyra e krijimit, kompetencat dhe funksionet e këtyre organeve janë caktuar në statutin e shoqërisë.

Neni 11

Neni 11

Administratori e Shoqerise

Ortaket ne unanimitet me njeri tjetrin, qe me neneshkrimin e kesaj kontrate, si administrator te vetem per tere kohen e egzistences se shoqerise caktuan ortakun Artur Kadare. Administrator me te gjitha kopetencat per ta perfaqesuar shoqerine jashte shqiperise caktohet ortakut Fotis Sarantopoulos, duke e patur kete te drejte edhe administratori Artur Kadare.

Neni 12

Ruajtja e dokumentacionit

Ortaket detyrohen reciprokisht qe te ruajne karakterin konfidencial te njoftimeve, te njohurive e te pervojës se fituar ne aktivitetin e shoqerise dhe te marimte gjitha masat e nevojshme, per mos perhapjen e tyre qofte edhe pjeserisht.

Ortaket pergjigjen per demet qe mund ti vijne shoqerise nga mos respektimi i detyrimeve te me sipërme.

Neni 13

Zgjidhja e mosmarveshjeve

Mosmarveshjet qe mund te lindin ndermjet ortakeve, kur nuk mund te zgjidhen nepermjet bisedimeve me pajtim, do te kalojne per zgjidhje ne gjykatën e rrethit Tirane.

Neni 14

Dispozita te fundit

Dispozita me te hollesishme per Shoqerine percaktohen ne statutin e saj, qe eshte pjese perberese e kesaj kontrate.


Kjo kontrate neneshkruhet rregullisht prej paleve ortake ne kete shoqeri ne tre kopje, sot ne datën 28.06.1993 ne Tirane.

O R T A K E T

ARTUR KADARE



FOTIS SARANTOPOULOS



Neni 4

Pjesmarja ne shoqeri nuk i pengon ortaket te kene pavaresi ligjore per veprimtari te tjera dhe per te drejta te tjera pronesie.

Ortaket qe marin pjese ne shoqeri, nuk pergjigjen per detyrimet e shoqerise qe rjedhin nga objekti i veprimtarise se saj, tej kapitalit themelor ne te cilin ata kane mare pjese. Po keshtu as shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet e ortakeve te saj.

Neni 5

Ortaket kane keto te drejta kryesore:



- Te marin pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me kontraten dhe statutin.
- Te marin pjese ne rezultatet e veprimtarise se shoqerise, ne çdo forme e sasie qofte, ne perputhje me kontraten dhe statutin.
- Te marin pjese vete ose nepermjet te perfaqesuesve te tyre ne organet e shoqerise qe jane krijuarv ose qe mund te krijohen.
- Te kerkojne e tu jepen te gjitha informatat qe kane te bejne me gjendjen tregetare dhe veprimtarine tjeter te shoqerise, si dhe gjith dokumentet e perpunuara nga shoqeria, si bilancet llogarite ekonomike etj.
- Te bejne propozime dhe ti paraqitin ato para organeve te shoqerise per shqyrtim.

Neni 6

Secili ortak pjesen e vet ne kapitalin themeltar (kuoten) mund tja transferoje personave te trete, qe nuk bejne pjese ne shoqeri, vetem me miratimin e ortakeve te tjere.

Projekti i vendimit te transferimit i njoftohet shoqerise dhe secilit prej ortakeve. Ne rast se shoqeria nuk ben te ditur vendimin e saj brenda tre diteve nga data e njoftimit te projekt vendimit, atehere miratimi i transferimit konsiderohet i dhene.

Ne rast se shoqeria refuzon te jape miratimin e transferimit, sec-



ili ortak brenda tre muajve nga data e ketij refuzimi, duhet te bleje ose te lejoje blerjen e pjeseve te kapitalit themeltar sipas vleres se percaktuar.

Neni 7

Ortaket kane keto detyra kryesore:

- Te depozitojne kuoten e tyre ne perputhje me aktin e themelimit te shoqerise(kontraten) dhe me kete statut.
- Te marin pjese ne administrimin e shoqerise nepermjet organeve te krijuara prej tyre, personalisht, ose me perfaqesuesit e tyre.
- Ti japin shoqerise informatat e nevojshme qe kane te bejne me veprimtarine e saj.
- Te kryejne sherbimet e nevojshme per aritjen e objektivave dhe realizimin e funksioneve te shoqerise.

Kreu i 11

Kushtet ekonomike

Neni 8

Veprimtaria e shoqerise realizohet ne baze te parimeve te llogarise ekonomike dhe pasqyrohet ne bilancet e saj.

Neni 9

Per te bere te mundur zhvillimin e veprimtarise se shoqerise caktohet nje kapital themelor prej 2500.000 ^{dy milion} (dy mijë e qind e njëzet e pesë) leke.

Ortaket marin pjese ne krijimin e kapitalit themelor te shoqerise me kuotat e tyre, qe percaktohen ne kontraten e themelimit te shoqerise.

Afatet e derdhjes se kapitalit themelor te shoqerise te ndare ne kuotat e secilit ortak caktohen nga administratori, i cili i depoziton ato ne banke per llogari te shoqerise.

Administratori u dorezon ortakëve nje dokument me te cilin vertetohet derdhja e kuotave ne para prej tyre.

Neni 10

Shoqëria është pronare, përdoruese dhe disponuese e pasurive të saj në përputhje me qëllimin e objektit të veprimtarisë të përcaktuar në këtë statut dhe në kontratën e themelimit.

Gjate veprimtarisë së saj shoqëria mund të blejë pasuri, të shfrytëzojë të drejta të tjera materiale, si dhe kur është rasti të ofrojë për garanci pasuritë e saj, për të marrë kredi bankare.

Neni 11

Shoqëria krijon fondin rezerve, ose dhe fonde të tjera të veçanta financimi për zhvillimin e saj, për nxitjen e veprimtarisë ekonomike etj.


Shoqëria krijon fondin rezerve, ose dhe fonde të tjera të veçanta dhe i disponon plotësisht mjetet financiare të këtyre fondeve si dhe çdo mjet tjetër financiar të saj. Detyrimet eventuale që mund të lindin gjate veprimtarisë së shoqërisë mbulohen nga fondi i rezerveve ose nga fondet e tjera.

Kur këto detyrime nuk mund të mbulohen nga fondet egzistuese ortakët në qoftë se bien dakort, mund të derdhen shuma suplementare për shlyerjen e tyre.

Neni 12

Fitimi i realizuar gjate një viti i nënshtrohet tatimit. Pas pagimit të tatimit fitimi që mbetet do të ndahet ndërmjet ortakëve në proporcion me pjesën që sipas kontratës i takon çdo ortakut në kapitalin themelor.

Fitimi që i takon ortakut të huaj, pasi të jenë paguar taksat që zbatohen në Shqipëri mund të transferohen jashtë shtetit pa asnjë pengesë.



Kreu i III
Administrimi
Neni 13

Organi vendimor i shoqerise eshte asamblea e ortakeve, e cila vendos per bilancin vjetor, per ndryshimet ne statut, per shtimin e kapitalit themelor, per emerimin e administratorit dhe shkarkimin e tij, per caktimin e drejtimeve kryesore te veprimtarise se shoqerise, si dhe per mbylljen e shoqerise.

Ortaket per mbledhjen e asamblese lajmerohen nga administratori me leter rekomande te pakten 15 dite perpara dates se mbledhjes. Ne kete leter njoftohet edhe rendi i dites.

çdo mbledhje e therritur ne menyre te pa rregullt mund te anulohet prej ortakeve. Megjithate anulimi i mbledhjes se asamblese se ortakeve nuk ka vlere, ne rast se te gjithë ortaket jane te pranishem ose te perfaqesuar ne mbledhje.

çdo ortak ka te drejte te mare pjese ne mbledhje e te votoje per marjen e vendimeve me te drejte vote te barabarte me ortaket e tjere.


Ne mbledhjet e asamblese nje ortak mund te perfaqesohet nga nje ortak tjetër.

Neni 14

Ne mbledhjet e asamblese, ose ne konsultimeme shkrim vendimet meren bashkerisht nga ortaket dhe kur ata nuk bien dakort vendos administratori.

Unanimitet per vendimet e asamblese se ortakeve detyrimisht duhet te kete per keto çeshtje:

- ndryshimet e statutit
- rritjen e pakesimin e kapitalit themelor
- zgjatjen e kohes se veprimtarise se shoqerise
- pushimin e veprimtarise se shoqerise.



Neni 15

Organi administrativ i shoqerise eshte adminisratori qe emrohet sipas propzimit te ortakeve. Administratori perfaqeson shoqerine kundrejt te treteye, brenda cazeve te veprimtarise se saj, si dhe kryem te gjitha veprimet e administrimit ne interes te shoqerise.

Kopetencat ekskluzive te administratotit jane:


- Te miratoje planet dhe llogarite ekonomike, pas perpunimit te tyre.
 - Te beje propozime ne asamblene e ortakeve, per ndryshime ne rast nevoje te kapitalit themeltar te shoqerise .
 - Te nxiere aktet aormative qe percaktojne raportet ne gjirin e shoqerise, duke perfshire kuadrin dhe personelin.
 - Te percaktoje strukturen e aparatit te shoqerise, numurin e puntoreve dhe pagat e tyre.
 - Te krijoje organe te tjera te shoqerise, te domosdoshme per mbarevajtjen e veprimtarise se saj.
 - Te vendose per krijimin e filialleve, degeve ose perfaqesive te shoqerise, ne qytete te tjera a qendra te banuara ne shqiperi.
 - Te mare kredi per afat gjata duke percaktuar me pare perdorimin e tyre.
 - Te lidhe kontrata te ndry hme, por me perjashtim te kontratave me pale persona fizike e juridike te huaj, te cilat do te lidhen vetem me miratimin e te dy ortakeve pale ne kete kontrate.
 - Te kryeje gjith veprimtarine operative te shoqerise dhe te siguroje zbatimin e perpikta te te vendimeve te assemblese te prtakeve.
- Te autorizoje kur e sheh te nevojshme persona te tjere per te kryer veprime te caktuara te kopetences se tij ne emer she per llogari te shoqerise.

Kreu i IV

Pushimi i Veprimtarise se Shoqerise

Neni 16

Veprimtaria e shoqerise pushon me mbarimin e afatit te percaktuar ne aktin e themelimit te saj (kontraten), ose edhe me pare kur gjate dy vjeteve te njepasnjeshem veprimtaria e saj nuk rezulton rentabel, si dhe kur te gjith ortaket heqin dore nga shoqeria e kerkojne pushimin e veprimtarise se saj.



12

Shoqeria shperndahet ne forme riorganizimi ose likuidimi.

Neni 17

Kur shoqeria likujdohet asamblea e ortakeve emeron komisionin e likujdimeti i cili i paraqet asaj bilancin e likujdimit. Shoqeria i jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te bilancit te likujdimit.

Neni 18

Mjetet financiare si dhe çdo pasuri tjeter e fituar si rezultat i veprimtarise se shoqerise, kur shoqeria likujdohet, ndahen ndermjet ortakeve, ne perpjestim me kuotat e tyre ne kapitalin themelor, pasi te jene bere pagesat per kreditorët.

Neni 19

Ky statut behet ne tri kopje dhe firmoset rregullisht nga ortakët et qe jane themelues te shoqerise sot ne daten, 28.06.1993

O R T A K E T

ARTUR KADARE



FOTIS SARANTOPULOS

